



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 514/3 Prot.

Tiranë, më 27.02.2025

VENDIM
Nr. 20, datë 27.02.2025

PËR
KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË DHE
PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË, NË
UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3 pika 4/b, neni 4 pika 1, neni 23 pika 4, neni 25 pika 8, neni 38 pika 1/a dhe 3, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, neni 74 pika 1, neni 76 pika 2, neni 135, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazuar në propozimet e njëjësive kryesore të UMT-së, dhe të diskutimeve në mbledhjen e datës 30.01.2025 të Rektoratit të UMT-së, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

- I. Kandidatët brenda vendit, që aplikojnë për pranim në programet e studimeve që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, duhet të kenë notën mesatare minimale¹, si më poshtë:

1. Mjekësi e Përgjithshme	≥8
2. Farmaci	≥8
3. Stomatologji	≥8
4. Shëndet Publik	≥7
5. Infermieri e Përgjithshme	≥7
6. Fizioterapi	≥7
7. Mami	≥7
8. Teknikë Imazherie	≥7
9. Teknikë Laboratori	≥7
10. Logopedi	≥7
11. Teknikë Dentare	≥7
12. Higjenist Dentar	≥7

¹ Nota mesatare minimale përlogaritët si mesatare aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm të lartë dhe mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore.

II.A Kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e integruar të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Mjekësi e Përgjithshme”, për vitin akademik 2026-2027, përbëhen nga:

- PAM - Pikët e fituara nga arsimit të mesëm të lartë **70%**;
- PTI - Pikët e fituara nga testimi i informatizuar për programin PICD “Mjekësi e Përgjithshme” **30%**;

PAM - Pikët e fituara nga arsimit të mesëm të lartë, përbëhen nga:

1. Nota mesatare aritmetike e arsimit të mesëm të lartë (për të gjitha vitet) **35%**.
2. Notat e lëndëve formuese të klasës 12 të² të arsimit të mesëm të lartë **15%**:
 - a) Fizikë (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;
 - b) Biologji (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;
 - c) Kimi (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;

Nëse kandidati zgjedh lëndë të tjera, nota llogaritet e barabartë me 0.

3. Nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore **50%**, ku:
 - a) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi, Fizikë, Biologji, nota e provimit shumëzohet me **1.5**.
 - b) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje, të ndryshme nga lëndët e përcaktuara në pikën a) të sipërcituar, nota e provimit shumëzohet me koeficientin **1**.

PTI - Pikët e fituara nga testimi i informatizuar, përbëhen nga:

1. Pikët e testimit të informatizuar janë pikët e fituara të testimit të shumëzuara me koeficientin e pikëve (KPTI)

Bashkëlidhur në formë të përmbledhur tabela nr. 1.A, për pikën I dhe II.A

II.B Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë (Bachelor) dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci” dhe “Stomatologji”, për vitin akademik 2026-2027, përbëhen nga:

1. Nota mesatare aritmetike e arsimit të mesëm të lartë (për të gjitha vitet) **35%**.
2. Notat e lëndëve formuese (të klasës 12-të) të arsimit të mesëm të lartë 15%:
 - a) Fizikë (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;
 - b) Biologji (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;
 - c) Kimi (lëndë me zgjedhje klasa 12 të) 5%;

Nëse kandidati zgjedh lëndë të tjera, nota llogaritet e barabartë me 0.

² Klasa e fundit e arsimit të mesëm të lartë.

3. Nota mesatare aritmetike e provimeve të Maturës Shtetërore **50%**, ku:

- c) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje: Kimi, Fizikë, Biologji, nota e provimit shumëzohet me **1.5**.
- d) Nëse një kandidat jep provim lëndë me zgjedhje, të ndryshme nga lëndët e përcaktuara në pikën a) të sipërcituar, nota e provimit shumëzohet me koeficientin **1**.

Bashkëlidhur në formë të përmbledhur tabela nr. 1.B, për pikën I dhe II.B.

III. Koeficientet sipas llojeve të shkollave të arsimit të mesëm të lartë që do të aplikohen për vlerësimin e kandidatëve që aplikojnë për të gjitha programet që ofron Universiteti i Mjekësisë, Tiranë janë sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV.A Formula e përlogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të renditjes së kandidatëve që do të aplikojnë në programin e studimit të integruar “*Mjekësi e Përgjithshme*” të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, do të jetë si më poshtë vijon:

$$PP = 70\% * PAM + 30\% * PTI$$

$$PP = (PTI * KPTI * 30\%) + \{[(M1 * 35) + ((NF * 5) + (NB * 5) + (NK * 5)) + ((D1 + D2 + D3 + Z1 * KZ1)/4 * 50)] * KSHM * 100 * 70\%$$

Shpjegim:

PP	Pikë të përgjithshme për renditje;
PAM	Pikët e fituara nga arsimit të mesëm të lartë;
PTI	Pikët e fituara nga testimi i informatizuar;
KPTI	Koeficienti i pikëve të testimit të informatizuar;
M1	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë;
NF	Nota përfundimtare e lëndës Fizikë klasa 12 të;
NB	Nota përfundimtare e lëndës Biologji klasa 12 të;
NK	Nota përfundimtare e lëndës Kimi klasa 12 të;
D1	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 1;
D2	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 2;
D3	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 3;
Z1	Provimi me zgjedhje i Maturës Shtetërore 1;
KZ1	Koeficienti i provimit të lëndës me zgjedhje në Maturën Shtetërore do të jetë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">• lëndët Kimi, Fizikë, Biologji, KZ=1.5• të gjitha lëndët e tjera KZ=1
KSHM	Koeficienti i shkollave të arsimit të mesëm të lartë, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV.B Formula e përlogaritjes së pikëve për kryerjen e procesit të renditjes së kandidatëve që do të aplikojnë në programet e studimit të ciklit Bachelor dhe të cikleve të integruara (*Stomatologji, Farmaci*) të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027, do të jetë si më poshtë vijon:

$$PP = \{(M1 * 35) + ((NF * 5) + (NB * 5) + (NK * 5)) + ((D1 + D2 + D3 + Z1 * KZ1) / 4 * 50)\} * KSHM * 100$$

Shpjegim:

PP	Pikë të përgjithshme për renditje;
M1	Nota mesatare aritmetike e thjeshtë për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë;
NF	Nota përfundimtare e lëndës Fizikë klasa 12 të;
NB	Nota përfundimtare e lëndës Biologji klasa 12 të;
NK	Nota përfundimtare e lëndës Kimi klasa 12 të;
D1	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 1;
D2	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 2;
D3	Provimi i detyruar i Maturës Shtetërore 3;
Z1	Provim me zgjedhje i Maturës Shtetërore 1;
KZ1	Koeficienti i provimit të lëndës me zgjedhje në Maturën Shtetërore do të jetë si më poshtë: <ul style="list-style-type: none">• lëndët Kimi, Fizikë, Biologji, KZ=1.5• të gjitha lëndët e tjera KZ=1
KSHM	Koeficienti i shkollave të arsimit të mesëm të lartë, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik dhe u përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Xheladin DRACINI



Tabela Nr. 1.A: Kriteret e pranimit në formë të përmbledhur për programin e integruar të ciklit të dytë "Mjekësi e Përgjithshme", në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027:

Universiteti	Nr	Cikli i studimit Bachelor/ Master i Shkencave	Emërtimi i Programit	Kriteret e pranimit						Shënime
				Nota mesatare sipas VKM	Pesha në % e pikëve të Testimit të Informatizuar (PTI)	Pesha në % e pikëve të Arsimit të Mesëm të Lartë (PAM)	Pesha në % e notës mesatare të arsimit të mesëm të lartë (për të gjitha vitet e studimit)	Pesha në % e notës mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore	PAM 70% përbehet nga:	
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	Master i Shkencave	Mjekësi e Përgjithshme	≥8	30%	70%	35%	50%	15%	<ul style="list-style-type: none"> Nëse kandidati zgjedh lëndë të tjera nga Kimi, Biologji, Fizikë, si lëndët me zgjedhje të klasës 12 të, nota llogaritet =0 Koeficienti që shumëzon notën e provimit me zgjedhje në Maturën Shtetërore për lëndët Kimi, Biologji, Fizikë = 1.5, për lëndë të tjera, koeficienti = 1

Tabela Nr. 1.B: Kriteret e pranimit në formë të përmbledhur për programet e studimeve të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027:

Universiteti	Nr.	Cikli i studimit Bachelor/ Master i Shkencave	Emërtimi i Programit	Kriteret e pranimit				
				Nota mesatare sipas VKM	Pesha në % e notës mesatare të arsimimit të lartë (për të gjitha vitet e studimit)	Pesha në % e notës mesatare e provimeve të Maturës Shtetërore	Notat e lëndëve formuese Kimi, Biologji, Fizikë (klasa 12 të)	Koeficienti që shumëzohet notën e provimit me zgjedhje në Maturën Shtetërore (klasa 12 të)
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	1	Master i Shkencave	Farmacj	≥8	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	2	Master i Shkencave	Stomatologji	≥8	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3	Bachelor	Shëndet Publik	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	4	Bachelor	Infermieri e Përgjithshme	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	5	Bachelor	Fizioterapi	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	6	Bachelor	Mami	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	7	Bachelor	Teknikë Imazherie	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	8	Bachelor	Teknikë Laboratori	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	9	Bachelor	Logopedi	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	10	Bachelor	Teknikë Dentare	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	11	Bachelor	Higjien Dentar	≥7	35%	50%	15%	Lënda Kimi, Biologji, Fizikë – koeficienti = 1.5. Për lëndë të tjera, koeficienti = 1

Tabela Nr. 2: Koeficientet sipas llojit të shkollës së arsimit të mesëm të lartë që kanë përfunduar kandidatët, të cilët aplikojnë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin akademik 2026-2027:

NR	LLOJI I SHKOLLËS SË MESME	KOEFICIENTI
1	GJIMNAZ	1.4
2	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-FRËNGJISHT	1.4
3	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-ITALISHT	1.4
4	SEKSION DY GJUHËSH SHQIP-GJERMANISHT	1.4
5	GJIMNAZ ME KOHË TË SHKURTUAR	1
6	GJIMNAZ GJUHËSOR	1
7	SHKOLLË ARTISTIKE/KOREOGRAFIKE	1
8	SHKOLLË SPORTIVE	1
9	SHKOLLË PEDAGOGJIKE	1
10	HOTELERI-TURIZËM	1
11	SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI	1
12	MEKANIKË	1
13	ELEKTROTEKNIKË	1
14	ELEKTRONIKË	1
15	PËRPUNIM DRURI	1
16	NDËRTIM	1
17	TEKSTIL-KONFEKSIONE	1
18	TEKNOLOGJI USHQIMORE	1
19	BUJQËSI	1
20	SHËRBIME SOCIALE DHE SHËNDETËSORE	1
21	VETERINARI	1
22	GJEODEZI	1
23	INSTALUES SISTEMEVE TERMOHIDRAULIKE	1
24	LLOGARI	1
25	SHËRBIME BANKARE	1
26	ADMINISTRIM BIZNESI	1
27	RRJETE TË DHËNASH	1
28	MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË TIK	1
29	ELEKTRONIKË NE TEKNOLOGJINË E AUTOMATIZIMIT	1
30	SILVIKULTURË	1
31	HARRY FULTZ, BIZNES	1
32	HARRY FULTZ, ELEKTRONIKË	1
33	HARRY FULTZ, AUTOMEKANIK	1
34	PETER MAHRINGER TEKNOLOGJI INFORMACIONI	1
35	PROFILE TË TJERA QË NUK JANË TË LISTUARA	1